

STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE

" Flotta-Trasporti Vento" SHPK

Titulli I

Data e themelimit, Emertimi, Objekti, Kohezgjatja, Zyra Qendrore, Forma e shocierise, Vula e shocierise

Neni 1: Data e themelimit, Emertimi dhe Themeluesit

Shoqeria Flotta-Trasporti Vento krijohet ne date 19.03.2023 nga ortaku si me poshte : **Giovanna Ferassutti** shtetase Italiane, lindur ne Itali ne Udine me pasaport nr YA9994161 **Giovanna Ferassutti**, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me me pasaport nr YA9994161 themeloi firmen Flotta-Trasporti Vento ne daten 19.03.2023

Neni 2: Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria eshte person juridik shqiptar. 2.2 Shoqeria gazon te drejta si person juridik shqiptar, qe prej dates ne te cilen kryhet regjistrimi i saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. 2.3 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

Neni 3: Forma e shocierise

3.1 Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, derisa me vendim te Asamblese se Pergjithshme te vendoset shnderrimi i formes ligjore.

Neni 4: Objekti

4.1 Shoqeria Flotta-Trasporti Vento do te kete si objekt te veprimtarise:

Shoqeria mund te kryeje aktivitet ne fushen e prodhimit te energjise elektrike nga burime te rinovueshme, por duke mos u kufizuar ne to, nga burime hidrike, te eres, fotovoltaike, punime germimi .

Neni 5: Kohezgjatja



5.1 Shoqeria **Flotta-Trasporti Vento** kryen veprimtarine e saj tregtare per nje periudhe kohore te pacaktuar derisa te vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme.

- 5.2 Shoqeria fiton personalitetin juridik ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nga kjo date ajo mund te filloje te ushtroje aktivitetin tregtar den i kur me 1 vendim te Asambleja e Pergjithshme te vendoset prishja e shoqerise ose kur shoqeria mbaron ne nje nga menytrat e parashikuara ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 6: Selia

6.1 Selia kryesore e shoqerise do te jete ne Njesia bashkiake nr 4, Rruga Tasim Shehu, , Pallati nr 179 , Kati Pare, Dyqani nr 6 , Tirane, Shqiperi Me vendim te Asamblese se Pergjithshme selia e shoqdrise mund te ndryshohet, mund te hapen dege, dhe zyra perfaqesimi te saj brenda dhe jashte Shqiperise.

Neni 7: Vula e Shoqerise

7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj duke shenuar ne te emertimin tregtar ose iniciale.

Neni 8: Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 20,000 leke (dhjete mije leke) , i cili eshte teresisht kapital financiar . Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote, me vlere nominale 20,000 leke (dhjete mije leke).

Kapitali themeltar zoterohet nga:

1. **Giovanna Ferassutti** zoterues i 1 (nje) kuote apo 100% te kapitalit te shoqerise.

Ortaku ka te drejte te tjetersoje, te zmadhoje apo te pakesoje kuotat e kapitalit deri ne kufinjte e percaktuara nga ligji. Kapitali fillestar nuk eshte paguar

Neni 9: Kuotat, te drejtat e lidhura me to

9.1 cdo kuote jep te drejten e nje vote per te mane vendime sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqdrite Tregtare". Te gjitha votat do te ushtrohen nga ortaket sipas zoterimeve.

Neni 10: Kuotat. Fitimi, Transferimi i kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit te shocierise mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shogerise, shitblerjes, trashigimise, dhurimit, apo cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Tidulli III

Asambleja e Pergjithshme

Neni 11: Asambleja e Pergjithshme. Thirrja e mbledhjes. Marrja e vendimeve. E drejta e votes

11.1 Asambleja e Pergjithshme, si organ kryesor i shoqerise sipas ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" perfaqesohet ne kete shoqeri nga ortaket.

11.2 Asambleja e Pergjithshme thirret me shkrese jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes, ne adresat e percaktuara ne dispoziten "Njoftimet" me poshte. Njoftimi duhet te permbaje: ditën, orën, vendin ku do te mbahet mbledhja si dhe rendin e dites.

11.3 Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit per te vendosur per ceshtje te tilla si miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit te auditimit te shoqerise.

11.4 Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise, apo edhe ne nje vend tjeter te njohur nga ortaku i vetem.

11.5 Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme.

Neni 12: Kompetencat e Asamblese

12.1 Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:

1. Percaktimin e politikave tregtare te shoqdrise;
2. Ndryshimin e Statutit;
3. Emerimin/shkarkimin e Administratorit, eksperteve kontabel, likujdatoreve;
4. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret pershire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
5. Miratimin e pasqyrave finaciare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
6. Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
7. Kryerjen e kontroll-revizionit financiar te shoqdrise me eksperte te caktuar prej saj;
8. Te vendose per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
9. Te vendose per riorganizimin dhe prishjen e shoqdrise;
10. ceshtje te tjera qe jand te rendesishme per aktivitetin tregtar te shoqerise.

Neni 13: Perfaqesimi ne Asamble

13.1 Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhje, ne rastet kur e ka te pamundur pjesemarrjen personalisht ne mbledhje, nga nje person i trete ose edhe nga nje ortak tjeter shoqdrrie.



Autorizimi duhet te kete te percaktuar qarte kompetencat e perfqesuesit si dhe te drejtat e tij lidhur me vendimarrjen ne mbledhje.

Titulli IV

Administratori

Neni 14: Administrimi i shoqerise

14.1 Shoqndria administrohet nga nje Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Pergjithshme. Administrator i shoqerise do te jete **Giovanna Ferassutti** shtetase Italiane, lindur ne Itali ne Udine me pasaport nr YA9994161. **Giovanna Ferassutti**, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, Afati i ushtrimit te detyres eshte 5 (pese) vjet me te drejte ripertesitje.

Neni 15: Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Pergjegjesite

15.1 Administratori ushtron kompetencat e meposhtme:

1. Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
2. Vepron me te tretet ne emer dhe per llogari te shoqerise brenda kompetencave te parashikuara ne statut apo/dhe ne ligj in "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
3. Kryen emerimin dhe shkarkimin nga puna te punemarresve te shoqerise.
4. Jep urdhra dhe udhezime punemarresve dhe vendos sanksione ndaj tyre, ne perputhje me kontratat e punes dhe rregulloret e brendshme te shoqerise;
5. Drejton dhe organizon punen ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare;
6. Te raportoje para Asamblese se Pergjithshme sa here qe Asambleja e kerkon si dhe ne rastet kur eshte i nevojshem raportimi ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
7. Te zbatoje vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme;
8. T'i paraqese ne menyre te rregullt dhe ne kohe te pershtatshme Asamblese se Pergjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogarite vjetore si dhe te pergjigjet per to.
9. Te ushtroje te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



10. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për fajë të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Neni 16: Mbarimi i mandatit të Administratorit

16.1 Mandati i Administratorit përfundon: -me mbarimin e afatit; -me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme; -kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht. 4 -sipas menyrave të tjera parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Titulli V

Viti Financiar. Prishja e Shoqërisë. Dispozitat e fundit.

Neni 17: Viti Financiar

17.1 Veprimet financiare mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë lidhur me nxjerrjen e bilancit të hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 18: Mbarimi i Shoqërisë

18.1 Shoqëria **Flotta-Trasporti Vento** mbaron: 1. Me vendim të Asamblese së Përgjithshme; 2. Me hapjen e procedurave të falimentimit; 3. Sipas shkakëve të tjera të parashikuara nga ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 19: Njoftimet

19.1 Njoftimi për ortakun duhet të kryhet sipas adresës së përcaktuar në Nenin 6 të këtij statuti. 19.2 Ortaku është i detyruar të njoftojë ndryshimet në adresën e tij.

Neni 20: Te ndryshme

20.1 Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

20.2 **Flotta-Trasporti Vento** regjistrohet sipas nenëve 26, 28, 32 e 35 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" 20.3 Statuti u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjta juridike.

THEMELUES

Giovanna Ferassutti

